



MISIONI SHQIPTAR

E Lumja Nënë Tereza

Blessed Mother Teresa Albanian Mission
739 Browns Line, Etobicoke, Ontario M8W 3V7
Tel. 416 503 4509 dhe 647 558 9382
www.misioninenetereza.com

Çdo të dielë në orën 12 Rruzarja dhe Mesha Shenjte

Buka Uji

2 Gusht 2015



Në atë kohë, kur njerëzit panë se aty nuk ishte Jezusi as nxënësit e tij, hynë në lundra dhe kaluan në Kafarnaum për të kërkuar Jezusin. Kur e gjetën në anën tjetër të detit, i thanë: “Rabbi, kur erdhe këtu?” Jezusi u përgjigji: “Përnjëmend, përnjëmend po ju them: më kërkoni, jo pse patë mrekullitë, por pse hëngrët nga ato bukë dhe u ngitë. Veproni, por jo për ushqim që prishet, por për një ushqim që qëndron për jetën e amshueshme: atë do t’jua japë Biri i njeriut, sepse këtë e vulosi Ati-Hyji.” Atëherë ata i thanë: “Çka na duhet të bëjmë për t’i kryer veprat që kërkon Hyji?” Jezusi u përgjigji: “Vepra që Hyji kërkon është kjo: besoni në atë që Ai e dërgoi.” “Çfarë shenje bën ti – i thanë ata – që ta shohim e të besojmë? Cila është vepra jote? Etërit tanë hëngrën mannën në shkreti si shkruan edhe në Shkrim shenjt: ‘U dha të hanin bukë prej qiellit’.” Jezusi u përgjigji: “Përnjëmend, përnjëmend po ju them: Nuk jua dha Moisiu bukën prej qiellit, por Ati im jua jep bukën prej qiellit, atë të vërtetën: sepse buka e Hyjit është ajo që zbret prej qiellit dhe që i jep botës jetën.” Atëherë i thanë: “Zotëri, na e jep vazhdimisht atë bukë!” Jezusi u përgjigji: “Unë jam buka e jetës. Kush vjen tek unë nuk do të ketë më kurrë uri, kush beson në mua, nuk do të ketë më etje. *Gjn 6, 24-35*

Mesha Shenjte....

Mesha kremtohet çdo të dielë në orën 12 pm te Kisha: Our Lady of the Miraculous Medal, **739 BROWN'S LINE, Etobicoke**, M8W 3V7 (Browns Line & Evans Avenue) Phone (416) 255-2721. Kisha ndodhet menjehere mbrapa Slovenia Credit Union. Public transport: Brown's Line at Coules Court North Farside (15 m N) 123. Per me shume informacion shih faqen internet: www.ourladyofmm.com

Kalendari liturgjik...

2 Gusht	Zoja e Engejve
5 Gusht	Zoja e bores
6 Gusht	Shnderrimi I Krishtit
9 Gusht	Tereza Benedikta e Kryqit



Viti 2015, kalendar aktivitetesh...

Te dielen **9 Gusht** dita e piknikut; te dielen **6 Shtator** shtegtimi ne Midland Ontario; te shtunen **28 Nëntor** Party festa e Pavaresise; te shtunen **19 Dhjetor** Christmas Party.

Njoftim per Meshe...

Te dielen **9 gusht** Mesha Shenjte nuk kremtohet ne Browns Line, por do jete ne **oren 1 te vendi I piknikut ne Norval**.

Haku Kishes 2015...

E ka dhene **Paulin Gjerka, Zef Lulaj**. Deri tani e kane dhene:

Aleks	Coku
Altin	Miri
Anton	Malaj
Anton	Tinaj
Anton	Brunga
Arben	Toma
Astrit	Simeqi
Beniamin	Hasko
Dritan	Lumaj
Edi	Linadi
Eduard	Shkreli
Elbert	Gashi
Gac	Gjoka
Gezim	Vushaj
Gezim	Lanazi
Gjelosh	Vushaj
Gjergj	Gjinaj
Kreshnik	Kapaj
Ladi	Lumaj
Leke	Kapllaj
Luk	Gjolaj
Lule	Tinaj
Marash	Martinaj
Marin	Muzhani
Martin	Pjetri
Mhill	Ftoni
Nik	Biqi
Nikolin	Vukelaj
Pjeter&Bep	Dreshaj
Prek	Lekaj
Preke	Gjonaj
Shpend	Pllumaj
Sokol	Ujka
Taulant/Elvis	Gjerkaj
Ton	Vocaj
Vladimir	Doda

Zoti ua shperblefte ne te mira e ua shtofte!

Per Hakun e Kishes: Vini re...

Sikur eshte caktuar me vendim te shumices se anetareve **Haku Vjetor i Kishes** eshte 500 dollare dhe mund te jipet ne cash, check ose me credit card (shih faqen website misioninenetereza.com Donate Now for Blessed Mother Teresa Mission), **ne nje shume te vetme ose pjese pjese gjate vitit. Ata te cilet per arsye te ndryshme jane ne veshtiresi te kontaktojne drejperdrejt me famullitarin.**

**Per projektin e Bustit te Nene Terezës ne
Midland Ontario kane dhene:**

Tonin	Kastrati
Aleks	Coku
Luk	Gjolaj
Mario	Martini
Pjeter&Bep	Dreshaj
Tom	Ivanaj
Zef	Deklaj
Anton	Malaj
Anton	Brunga
Arben	Toma
Dode	Ndreu
Emiljan	Zadrima
Gjergj	Nikolla
Lek	Selmani
Luigj	Narkaj
Luvigj	Lallinaj
Mhill	Bregu
Mirash	Lallinaj
Ndue	Kabashi
Nik	Biqi
Nue	Nikçi
Paulin	Marku
Pjerin	Kalaj
Prek	Gjonaj
Silvan	Nerhati
Sokol	Sterbyci
Vasel	Dreshaj
Martin	Vuktilaj
Aleks	Dragu
Altin	Miri
Balto	Toma
Ferdinand	Selmani
Ladi	Lumaj
Milazim	Ahmeti
Ndua	Selmani
Nush	Kacaj
Petrit	Ujka
Petrit	Ujkaj
Pjeter	Preka
Sokol	Ujka
Ton	Vocaj
Vilson	Prekaj
Aleks	Stolaj
Aleksander	Zefi
Anesti	Shyti

Arben	Odri
Ardian	Dashi
Ben	Tinaj
Beniamin	Hasko
Besmir	Rumi
Bledar	Toma
Dede	Ukaj
Elbert	Gashi
Erlis	Lleshi
Ferdinant	Grabanica
Gazmend	Kajtazi
Gezim	Qafalijaj
Gjergj	Kabashi
Gjovalin	Imeri
Ilir	Gjokaj
Kol	Pepaj
Lodovik	Dokaj
Mhill	Kabashi
Nysret	Caka
Petrit	Stolaj
Pjeter	Tunaj
Prek	Spaqi
Sander	Ndeshenaj
Sokol	Vushaj
Tot Prek	Ulaj
Valentin	Vataj
Valet	Noshi
Viktor	Gjokaj
Vitor	Mernacaj
Vladimir	Doda
Artan	Hasanaj
Gjergj	Gjinaj
Lin	Bujaj
Luigj	Gjokaj
Marash	Ndresaj
Martin	Elezaj
Nike	Geci

**Te gjithë Zoti i bekoftë dhe E Lumja Nene
Tereza i ndihmoftë.**

**Dom Aleksandër Sirdani e dom
Pjetër Çuni në përvjetorin e
vrasjes**

Më 31 korrik u perkujtua përvjetori i vrasjes së dy klerikëve martirë, dom Aleksandër Sirdanit (1892-1948) e dom

Pjetër Çunit (1914-1948). Xhelatët e diktaturës komuniste të Shqipërisë, pikërisht 63 vjet më parë i mbytën të dy Martirët për së gjalli në një gropë gjirizi, në Koplik, ku zhvillohej hetuesia e meshtarëve.

Dom Aleksandër Sirdani e dom Dedë Çuni qenë dy figura të shquara, jo vetëm të Kishës katolike, por edhe të kulturës, sidomos dom Sirdani, një nga firmat më të njohura, që botoi në shumë organe të shtypit të kohës, sidomos në revistën famëmadhe të jezuitëve 'LEKA'.

Prandaj, duhet kujtuar atë çka ndodhi në të kaluarën, nga e cila duhet mësuar shumë, në mënyrë pozitive, në se nuk duam të mos përsëritet e keqja, dhuna, përndjekja, padrejtësitë e diktatura, në se nuk duam që njerëz të tjerë, të pafajshëm, të përfundojnë në gropat e ujërave të zeza, si dy Martirët që përkujtojmë sot, që sigurisht nuk kanë rënë në harresë, e as do të bien, sepse janë shkruar tashmë në listën e martirëve të Kishës Katolike Shqiptare e asaj Universale, që pritet t'i ngjitet në nderimin më të lartë, atë të elterit e janë në zemrën e mendjen e njerëzve që nuk e harrojnë kontributin dhe gjakun e atyre, që e dhuruan për liri e për vlera shpirtërore e demokratike

Dom Ndre Mjeda, Mësues Feje e Poezie - në përvjetorin e vdekjes.

Si meshtar, dom Ndre Mjeda punoi si famullitar në komunitete të ndryshme kishtare në disa fshatra, ndërsa u lidh me lëvizjen patriotike.

Në vitin 1901, bashkë me të vëllain, Imzot Lazër Mjedjen, themeloi shoqërinë "Agimi", e cila krijoi një alfabet dhe botoi një varg librash për shkollat mbi bazën e këtij alfabeti. Për veprimtari patriotike autoritetet osmane e arrestuan. Në vitin 1908, në Kongresin e Manastirit, u zgjodh anëtar i komisionit për hartimin e alfabetit të njësuar të shqipes. Në periudhën e

Lëvizjes Demokratike dom Ndre Mjeda mori pjesë në jetën politike të kohës dhe u zgjodh deputet. Pas dështimit të Revolucionit Demokratik u tërhoq nga jeta politike dhe punoi si prift i thjeshtë në Kukël. Në vitet e fundit të jetës ishte mësues i gjuhës shqipe në Shkodër, ku dhe ndërroi jetë në gusht të vitit 1937. Veprimtarinë poetike dom Ndre Mjeda e nisi që herët. Poema romantike e njohur "Vaji i bylbylit" u shkrua më 1887; në të ndihen fryma patriotike dhe nota përmallimi. Vepra përmbyllej me thirrjen drejtuar shqiptarit që të ngrihej për të fituar lirinë. Që nga kjo kohë e deri më 1917, kur pa dritën e botimit "Juvenilja", Ndre Mjeda shkroi, por nuk botoi gati asgjë. Të kësaj kohe janë poema tjetër romantike "I tretuni", në të cilën është derdhur malli për atdheun, për njerëzit dhe natyrën e vendit, vjersha "Shtegtari", "Malli për atdhe", "Gjuha shqype", "Bashkonju" etj. Ndre Mjeda hartoi edhe vepra poetike si "Liria", ku gjeti pasqyrim demokratizimi, që, bashkë me patriotizmin, përbën anën më të fortë të botëkuptimit dhe të krijimtarisë së tij. Fazës së dytë të krijimtarisë së dom Ndre Mjedës, e cila nisi pas Luftës së Parë Botërore, i përkasin poemat "Scodra" dhe "Lissus", ku përmes historisë së lashtë të dy qyteteve evokohet e kaluara e hershme e popullit tonë dhe sidomos periudha e ilirëve. Në prodhimin poetik të Ndre Mjedës zënë vend edhe vjershat për fëmijë, disa shqipërime të goditura etj, ku tregoi mjeshtëri të rrallë poetike.

Dom Ndre Mjeda dha ndihmën e tij edhe në fushën e gjuhësisë. Puna e tij u zhvillua edhe në gramatikë, leksikologji, filologji, duke dhënë ndihmesë të shquar në lëvrimin e gjuhës letrare. Ndre Mjeda është ndër të parët gjuhëtarë shqiptarë që u morën me studimin dhe transkriptimin e veprave të letërsisë sonë të vjetër. Transkriptoi pjesërisht veprën e P. Bogdanit dhe të P. Budit, shkroi për dialektin shqiptar të Istries dhe për Perikopenë e ungjillit të shek. XIV.